REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-17685
Dt. 14.08.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Kadri (Hamëz) Gashi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin – ngritjen e katit të objektit ekzistues të kategorisë së dytë, me destinim të përzier, ekonomik dhe banim (depo e materialit sanitar dhe banim në katin e dytë), etazhiteti për këtë fazë është Kati i dytë dhe kulmi – korridori me shkallë, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: Aplikuesit: Kadri (Hamëz) Gashi nga Gjakova, ndërtimi – ngritja e katit të Objektit Ekzistues të kategorisë së dytë, me destinim të përzier, ekonomik dhe banim (depo e materialit sanitar dhe banim në katin e dytë), i cili posedon me Leje Ndërtimore për etazhitetitn B+P+1 (Aktvendimi me nr.07-351-41840, dt. 21.09.2016), sipas projektit kryesor të prezentuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore me nr. 07-351/01-18498, dt.21.06.2016, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 5542/4, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Gaspër Karaqi", në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin – ngritjen e katit të objektit ekzistues në fjalë, etazhiteti i objektit për këtë fazë është etazhiteti për këtë fazë është Kati i dytë dhe kulmi – korridori me shkallë, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit **S= 738.49 m².**

Kati i dytë: **(Sip,Bruto): S= 738.49 m²**
Kulmi – korridori me shkallë: **(Sip,Bruto): S= 28.26 m²**

II. Hartimin e projektit kryesor me destinim: ndërtimi – ngritja e katit të objektit ekzistues të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për projektim ndërtim dhe inxhiniering "Art - ING" - Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kadri (Hamëz) Gashi nga Gjakova, me banim në rrugën "Korab Binxhiu" nr. 54, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/02-17685 të datës 01.08.2017 për dhënin e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim të përzier, ekonomik dhe banim (depo e materialit sanitar dhe banim në katin e dytë), etazhiteti për këtë fazë është Kati i dytë dhe kulmi – korridori me shkallë, në ngastrën kadastrale me nr. 5542/4, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Gaspër Karaqi", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 03.05.2017, të punuar nga N.SH"GEOGAUSS"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 26.07.2017 (fotokopje) në pronësi të Kadri (Homëz) Gashi nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me nr.të lëndës 3740/17, të datës 21.07.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Lejen Ndërtimore – Aktvendimi nr.07-351-41840, dt.21.09.2016, të lëshuar nga DUMM.
5. Vendimin për Kushte Ndërtimore me nr. 07-351- 18498 të datës 21.06.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin – ngritjen e katit të objektit ekzistues të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 5542/4, Gjakovë –J- Qytet, të lëshuar nga DUMM.
6. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320-34013, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
7. Pëlqimin Sanitar me nr. 14/53/39131, dt.26.08.2016, nga Inspektoriati Sanitar – Drejtoria për Punë Inspektuese e Komunës së Gjakovës.
8. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.11/16 me datë 01.08.2016, lëshuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjakovës.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-B-337 të datës 21.07.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.620/1 të datës 28.06.2016.
11. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A. Gjakovë, nr.2086 të datës 24.06.2016.
12. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 23.06.2017.
13. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në TEB, SH.A., filiala Gjakovë me datë 07.08.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja për projektim ndërtim dhe inxhiniering "Art - ING" - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 3567.68 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit,**
- **Arhivës.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani. jur.dipl.

U.D. D r e j t o r i

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë J. Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m²
P - 70705028 - 005542 - 4	Parcelë \ Parcela \ Parcel	2250.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:2500

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 26.07.2017
Koha \ Vreme \ Time : 14:20:17
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture: _____
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Aproved : Drejtori \ Direktor \ Director
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture: _____

K.K. GJAKOVË

Zon. kadastrale :Gj.j.Qytet

Parcela nr. 5542-4

PLAN SITUACIONI



Gjakovë: 21.06.2016

Punoi: Durrije Berisha I.D.A

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtja e Mjedisit Gjakovë
Gjakovica • Odeljenje za Urbanizam • Zaštita životne sredine • Direktorijat

3. Maj 2016v.
Takeometri preqize
uto CAD 2004

P = 1 : 500

Punoi : N.SH. "Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Tertini gjeom.